



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 maj 2012
Nr. ref.: RK232/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI150/11

Parashtrues

Naser Shala

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit Gjykatës Supreme të Kosovës
A. nr. 396/11, të 7 qershorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është Naser Shala, banor i Prishtinës.

Objekti i çështjes

- Objekti i çështjes në kërkesë është shkëlja e pretenduar e të drejtës së parashtruesit për pensionin invalidor të garantuar me Ligjin nr. 02/L- për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Heronjve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe të Familjeve të Viktimave Civile të Luftës.

Baza juridike

- Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit nr. 03/LO121 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe Rregullin 56(2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

- Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 396/11, të datës 7 qershor 2011, që parashtruesit i është dorëzuar më 10 tetor 2011.

Procedura në Gjykatë

- Më 21 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
- Më 17 janar 2011, Kryetari caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Enver Hasani.
- Më 4 maj 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

- Sipas dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi faktet e rastit mund të përmbliidhen si në vijim:
- Më 28 janar 2011, Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë me Vendimin e vet nr. 01-01/7043 hodhi poshtë ankesën e parashtruesit për pensionin invalidor të UÇK-së sepse i mungonte certifikata origjinale nga Zyra Qendrore e TMK-së.
- Parashtruesi, i pakënaqur me këtë vendim, u ankua në divizionin e ankesave të departamentit të lartpërmendur.
- Divizioni i ankesave, më 8 prill 2011, ka sjellë vendimin e vet dhe hodhi poshtë ankesën e parashtruesit. Sipas vendimit të 8 prillit 2011, ankesa e parashtruesit është hedhur poshtë sepse dokumenti i paraqitur nga parashtruesi nuk dëshmonte që ai ishte anëtar i UÇK-së dhe që ishte plagosur mes datës 30.12.1991 dhe 19.09.1999 gjatë periudhës së veprimit në UÇK, ashtu si përshkruhet në nenin 7.4 dhe nenin 19, paragrafi 4 të Ligjit për vlerat e luftës nr.02/L (në tekstin e mëtejme: Ligji nr. 02/L) dhe Urdhëresa Administrative nr. 09/2006 të MPMS.
- Parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme për anulimin e vendimit të 8 prillit 2011. Parashtruesi pohoi se vendimi i kontestuar ishte i padrejtë dhe joligjor për shkak të konfirmimit jo të plotë dhe të gabuar të situatës faktike dhe zbatimin e gabueshëm të

së drejtës materiale. Parashtruesi thekson se autoriteti i shkallës së parë ka konstatuar situatën faktike në mënyrë të gabuar, pa shqyrtuar si duhet dokumentet mjekësore të paraqitura nga parashtruesi.

13. Më 7 qershor 2011, Gjykata Supreme me Aktgjykimin A. nr. 396/2011 hodhi poshtë ankesën e parashtruesit. Gjykata Supreme erdhi në përfundim se divizioni i ankesave në Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, ka konfirmuar situatën faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë kur ka hedhur poshtë ankesën e parashtruesit. Gjykata Supreme u pajtua me arsyetimin e vendimit të parë dhe të dytë administrativ se parashtruesi ka dështuar të paraqesë certifikatën që do të dëshmonte datën dhe vendin e plagosjes së supozuar të parashtruesit gjatë kryerjes së detyrës si ushtar i UÇK-së.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme si dhe organet administrative kanë vërtetuar faktet në mënyrë jo të drejtë, dhe se në fakt ai ka qenë pjesëtar i plagosur i UÇK-së i cili pra ka të drejtë në përfitime sipas ligjeve në fuqi.
15. Parashtruesi pretendon se janë shkelur dispozitat përkatëse të Ligjit n3. 02/L-2 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Heronjve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës.
16. Parashtruesi thjeshtë pretendon se gjykatat e mëparshme kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të GJEDNJ.

Vlerësimi i pranueshmërisë

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë.
18. Sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të veprojë si gjykatë e apelit lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
19. Në rastin e ankesës së parashtruesit për pension invalidor, parashtruesit i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile dhe para Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
20. Përfundimisht, kërkesa për pranueshmëri nuk është përmbushur në këtë kërkesë. Parashtruesi ka dështuar të mbështesë pretendimin se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të tij.
21. Prandaj, del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me Rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës që përcakton: "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese."

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Kadri Kryeziu
Zëvendëskryetar

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani